



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor

A.nr. 158/2021

Datë: 24.05.2021

Prishtinë;

Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 1 paragrafi 1 dhe pika 1.1, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit nr.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit me qëllim të zbatimit dhe monitorimit të Planit të punës , ngritjes së efikasitetit dhe rritjes së transparencës, nxjerrë këtë;

UDHËZIM

Për Zbatimin, Monitorimin, Raportimin dhe Publikimin e Aktiviteteve të Prokurorit të Shtetit

1. Të publikohen të gjitha aktivitetet dhe raportet e Prokurorit të Shtetit, të realizuara në kuadër të përgjegjësiave dhe obligime ligjore, duke përfshirë;
 - Raportet e rregullta të punës duke i përfshirë ato periodike dhe vjetore;
 - Raportet periodike për monitorimin e zbatimit të Planit të Punës;
 - Raportet e të gjithë koordinatorëve të caktuar nga Kryeprokurori i Shtetit;
 - Të gjitha aktivitetet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe të prokurorive tjera.
2. Të gjithë koordinatorët e caktuar me vendim të Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokurorët e caktuar në grupet punuese duhet të raportojnë rregullisht me shkrim të Kryeprokurori i Shtetit për ecurinë e fushëveprimtarisë për të cilën janë të caktuar.
3. Po ashtu edhe koordinatorët dhe prokurorët e caktuar nga kryeprokurorët e niveleve tjera të prokurorive duhet të raportojnë rregullisht me shkrim te kryeprokurorët nga të cilët janë caktuar.
4. Krijohet grupi monitorues, me qëllim të përcjellës së zbatimit të Planit të Punës së Prokurorit të Shtetit me këtë përbërje;
 - Një prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;

- Kryeprokurorët e prokurorive dhe administratorët;
- Këshilltari për media i Kryeprokurorit të Shtetit;
- Zyrtarët e Zyrës për Komunikim Publik në ZKPSH;

Arsyetimi

Me qëllim të ngritjes së transparencës, llogaridhënies si dhe monitorimit sistematik të punës dhe aktiviteteve të Prokurorit të Shtetit, të koordinatorëve të emëruar për fushëveprimtari të caktuara, si dhe të prokurorëve të caktuar në grupe të ndryshme punuese, Kryeprokurori i Shtetit nxjerrë këtë udhëzim, i cili, ka për synim të rrisë efikasitetin, mbikëqyrjen dhe të avancojë transparencën e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Gjithashtu, ky udhëzim ka për synim që të gjithë koordinatorët dhe prokurorët e angazhuar nëpër fusha të caktuara të raportojnë dhe ta mbajnë të informuar me shkrim Kryeprokurorin e Shtetit për ecurinë, zbatimin, sfidat, të arriturat dhe rekomandimet e dalura për fushat përkatëse në të cilat janë të angazhuar.

Përmes këtij udhëzimi do të krijohet grupi monitorues për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Punës, aktiviteteve si dhe publikimin e raporteve të monitorimit në ueb faqen zyrtare të sistemit prokurorial, duke iu ofruar kështu qasje mediave, shoqërisë civile dhe publikut të gjerë lidhur me punën e Prokurorit të Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Kryeprokurori i Shtetit.

Mos respektimi i këtij udhëzimi mund të konsiderohet si shkelje të Kodit të Etikës për kryeprokurorë dhe prokurorë.

Kryeprokurori i Shtetit

Aleksandër Lumezi



Udhëzimi i dërgohet;

- Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit dhe Prokurorisë Speciale;
- Kryeprokurorëve të prokurorive themelore dhe të gjithë prokurorëve të shtetit;
- Koordinatorëve dhe prokurorëve të caktuar nga Kryeprokurori i Shtetit dhe kryeprokurorët e prokurorive përkatëse;
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH).

Obligohet administrata e ZKPSH-së që këtë udhëzim ta publikoj në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit.